



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 135 Datë 04.11.2020

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015** “ Për vetqeverisjen vendore”, **Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016** “ Për Prefektin e Qarkut “, **Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019** “ Për Mbrojtjen Civile”, **VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012** “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” **kreu III, pika 1, gërma ë**, dhe kreu III pika 3 germa ç, Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, vendosi me datë 04.11.2020 me 21 vota pro 0 vota kundër 0 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 2 kat** në pronësi të **z. Qazim Losha** njësia administrative Muhurr (fshati Rreth - Kale) në shumën totale **871318** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **597518** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **273800** lekë.
3. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër i dëmtuari është trajtuar në shumën prej **87132** lekë (20% e 50 % të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar. sipas Vendimit të Keshillit Bashkiak nr 76 date 02.08.2017
4. Për pjesën tjetër të vlerës së patrajtuar, nga bashkia në masën 50 % të vlerës sipas nenit 41 të Ligjit Nr.45 date 18.07.2020 "Për Mbrojtjen Civile" dhe VKM Nr.329 date 16.05.2012, kreu III , pika 3, germa ç , diferenca për trajtim nga programi “**Emergjencave Civile**”, është **348527** leke.
5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e PPECK dhe Drejtorja Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

